



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 15.01.2021, mori në shqyrtim praktikat e përgatitura nga drejtoritë teknike e ERE-s, dhe u shpreh si më poshtë:

1. Mbi kërkesën e shoqërisë OST sh.a., për zgjatjen e afatit për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s, Nr. 169, datë 03.11.2020, “Për shqyrtimin e planit të investimeve për vitin 2020 dhe atë të përditësuar dhjetëvjeçar 2015-2025 të zhvillimit të rrjetit të transmetimit të shoqërisë OST sh.a..
2. Mbi kërkesën e FSHU sh.a. për disa ndryshime në “Kontratën Tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike/KESH sh.a, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe furnizuesi i shërbimit universal/FSHU sh.a. për furnizimin e klientëve fundorë.
3. Mbi anulimin e vendimit të Bordit të ERE Nr. 226, datë 15.12.2020, mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës Nr. 209, seria TL3, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “SHUTINA ENERGI” sh.p.k., me vendimin e bordit të ERE-s Nr. 109, datë 01.10.2013.
4. Mbi kërkesën e Albgaz për shtyrjen e afateve të përcaktuara në rregulloren e kriterëve standarde dhe kërkesave minimale të cilësisë së shërbimit dhe furnizimit të rrjeteve të gazit natyror.
5. Mbi miratimin e formularit të përditësuar të ankesave të klientëve të energjisë elektrike dhe gazit natyror.